

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-23-6462-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizimi dhe Mirëmbajtja e Parkut të Lodrave në Lagjen Ulpianë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	N.T.P. LULISHTJA BUÇAJ
NUI	810718075
Adresa	GUSHTERICË E ULËT
Vendi	GRAÇANICË
Kodi postar	10500
Numri Telefonit	048 696969 / 048504408
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	PLEURAT BUÇAJ
Adresa elektronike	lulishtjabucaj@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	10.10.2023

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizimi dhe Mirëmbajtja e Parkut të Lodrave në Lagjen Ulpianë

1. Njoftimi për kontratë -22.06.2023
2. Afati i fundit për dorëzimin e tenderit 02.08.2023 ora 13:30:00
3. Kriteret për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët
4. B58-Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues 22.08.2023
5. Kerkese për Rishqyrtim 28.08.2023
6. Vendim për rishqyrtim 01.09.2023
7. Letër Standarde Sqaruese 13.09.2023
8. Sqarim i Tenderit 15.09.2023
9. Njoftimi mbi Vendimin e AK-se 20.09.2023
10. Kerkese për rishqyrtim nga OE “Selmans Network” 25.09.2023
11. Vendim për Rishqyrtim 02.10.2023
12. Kerkese për qasje në dokumentacion 02.10.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga

AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me date: 25.09.2023, OE " Selmans Network" ka parashtruar kerkese per rishqyrtim.

Zyrtari Pergjegjes i Prokurimit ka aprovuar kerkesen per rishqyrtim, duke mos marre vendim Brenda afatit 3 ditor dhe ka tejkualuar te gjitha afatet per marrjen e vendimit dhe poashtu edhe ne raste te jashtezakonshme ne rast te zgjatjes se afatit per 3 dite tjera shtese eshte e obliguar qe me njoftim per shtyrje te afatit ta njoftoje palen ankimore gje te cilen nuk e ka bere duke shkelur dispozitat ligjore.

OE: Lulishtja Buçaj ka bere kerkese per qasje ne dokumentacion me date 02.10.2023

OE: Lulishtja Buçaj ka pasur qasje ne dokumentacion me daten 03.10.2023.

OE: Lulishtja Buçaj me date: 04.10.2023 ka bere kerkese per rishyrtim, per te cilen nuk eshte marre asnje vendim nga ana e AK-se brenda 3 diteve, po ashtu nuk jemi njoftuar si pale ankimore per shtyryere te afatit 3 dite shtese, duke kaluar cdo afat kohor.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042

Neni 7: Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 108/A nga pika 1 deri 11

**Neni 109: Afatet për Dorëzimin e Ankesës
RRPP**

Neni 61

Neni 61.3

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizimi dhe Mirëmbajtja e Parkut të Lodrave në Lagjen Ulpianë, me nr. Te prok: 616-23-6462-2-1-1, me date 20.09.2023 ka bërë Njoftimin mbi Vendimin e AK-se me cka është rekomanduar për shpërbllim të kontratës GOE: Lulishtja Buqaj & Metropolis.

Me date: 25.09.2023, OE “Selmans Network” ka parashtruar kerkese për rishqyrtim duke mos kerkuar qasje në dokumente zyrtare dhe poashtu kerkesa për rishqyrtim ka baze të kunderligjshmerise pasi që përmbajtja e saj është ri-vlerësuar nga komisioni I ri-vlerësimit për të kerkuar sqarim shtese lidhur me EN ISO standard që lidhet me temperature e gomes -30 130 grade Celsius.

Zyrtari Përgjegjës I Prokurimit z. Shehu me vendim ka aprovuar kerkesen për rishqyrtim duke shkelur nenin 61 të Rrregullores për Prokurimin Publik pasi që nuk ka ngritur vendim për pezullim të aktivitetit poashtu ka shkelur nenin 61 par.3 duke mos marrë vendim Brenda afatit 3 ditor dhe ka tejkaluar të gjitha afatet për marrjen e vendimit dhe poashtu edhe në raste të jashtëzakonshme në rast të zgjatjes së afatit për 3 dite tjera shtese është e obliguar që me njoftim për shtyrje të afatit të njoftojë palen ankimore gjë që cilën nuk e ka bërë duke shkelur dispozitat ligjore.

Poashtu Vendimi për aprovimin e kerkeses për rishqyrtim është I kunderligjshëm pasi që në përmbajtje të vendimit theksohet që komisioni i ri-vlerësimit nuk ka kerkuar sqarim lidhur me EN ISO standardin për temperature e gomes, ndërsa në sistemin elektronik të E-Prokurimit mbi bazën e provave verëhet qartë se Komisioni I Ri-Vlerësimit ka kerkuar sqarim përmes letres standard dhe sqarimet janë të ngarkuara në sistemin elektronik E-Prokurimi.

Si është e mundur që ZPP të marrë vendim mbi bazën e lajthimit dhe mashtrimit në përmbajtjen e saj kur provat janë të vendosura në sistemin elektronik E-Prokurimi ndërsa në vendim thuhet që komisioni I ri-vlerësimit nuk ka kerkuar sqarime shtese.

ZPP poashtu ka qene I njoftuar me raportin e ri-vleresimit nga ana e komisionit te ri-vleresimit dhe poashtu ka qene I njoftuar me gjithë ecurine e procesit te ri-vleresimit.

OE: Lulishtja Buqaj me date: 03.10.2023 ka pasur qasje ne dokumente zyrtare me cka ka marre dokumentet sic jane letrat standarde per sqarime, kerkesen per rishqyrtim te OE ankimor si dhe vendimin per aprovim nga ZPP, poashtu ka kerkuar se a ka qene ne qasje ne dokumente zyrtare OE ankimor "Selmans Network" dhe shihet qarte qe OE ankimor nuk ka kerkuar qasje ne dokumente zyrtare dhe si I tille I njeiti ka perserit kerkesen per rishqyrtim sikur heren e pare me cka ZPP ne menyre te kunderligjshme te njeiten ia aprovon duke mashtruar ne permbajtje te vendimit pasi qe ka tentuar te fus ne lajthitje dhe mashtrim komisionin e ri-vleresimit ku ka cituar se komisioni nuk ka kerkuar sqarime shtese.

Poashtu ZPPme vetdije te plote ka kryer veper penale te mashtrimit sipas kodit penal te Kosoves permes vendimit me shkrim pasi qe ne vendim ka mashtruar duke theksuar se Komisioni I RI-VLERESIMIT nuk ka kerkuar sqarime shtese ndersa nuk eshte e vertete pasi qe komisioni I ri-vleresimit ka kerkuar sqarime shtese dhe te njejtat jane te ngarkuara ne system elektronik.

Provat:

ISO STANDARDET dhe MARREVESHJA ME PRODHUESIIN;

NJOFTIMI MBI VENDIMIN PER REKOMANDIM PER DHENIE;

RAPORTI I VLERESIMIT – HERA E PARE – APROVUAR;

NJOFTIMI MBI VENDIMIN PER REKOMANDIM PER DHENIE;

RAPORTI I RI-VLERESIMIT – HERA E DYTE – APROVUAR

NJOFTIMI MBI VENDIMIN PER REKOMANDIM PER DHENIE;

LETET STANDARDE PER SQARIM TE TENDERIT

SQARIMI I TENDERIT

VENDIMET PER RISHQYRTIM TE APROVUARA NE MENYRE TE KUNDERLIGJSHME.

Po ashtu ne si OE "Lulishtja Buqaj" kemi parashtruar kerkese per Rishqyrtim me date 04.10.2023 per te cilen Autoritet Kontraktues nuk ka kthyer pergjigje me vendim brenda afatit kohor 3 ditor dhe as nuk jemi njoftuar per afat shtese 3 ditor. Sipas ligjit te LPP-se 108/ A pika 6 dhe ligjit te RRPP-se 61.3 AK eshte i obliguar te njoftoi palen ankimore dhe te marre vendimin brenda afatit kohor. Heshtja ne procedure administrative konsiderohet si aprovim i kerkeses.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmi material që ne supozojmë se na është bërë i referohet fitimit të humbur që afërsisht përfshin 25% të vlerës totale të çmimit të ofertuar.

Propozojmë që të rishikohet dosja e tenderit të lartë cekur dhe të na ipet kontrata pasi jemi i vetmi operator ekonomik i pergjegjshëm.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*